

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M.Sh. nga M., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. 2 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.85/2016 datë 27.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.69/2017 datë 28.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M.Sh. anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.85/2016 datë 27.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.69/2017 datë 28.8.2017, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për gjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.85/2016 datë 27.12.2016, i dënuari M.Sh., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. 2 të KPK dhe për këtë vepër i është shqiptuar dënimi me kusht në të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 3 (tri) vitesh nuk kryen vepër tjetër penale. Është detyruar që në afat prej 6 (gjashtë) muajve t'ia kthejë banesën të dëmtuarit sipas kontratës së datës 20.10.2007, në të kundërtën dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.69/2017 datë 28.8.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit M.Sh., ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M.Sh., G.R., avokat nga Mitrovica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr. 236/2017 datë 21.12.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK, të cilat shkelje konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin. Më pas citohet një segment nga dispozitivi për të theksuar se në dispozitiv nuk ekziston përshkrimi i veprimeve konkrete të ndërmarra nga i dënuari, pra, se si e ka mashtruar të dëmtuarin B.B. dhe në çfarë mënyre ai është sjellë në lajthim nga i dënuari. Pretendohet se në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare lidhur me veprën penale të mashtrimit sepse në arsyetim plotësisht mungojnë arsye për veprimet inkriminuese të mashtrimit respektivisht se në çfarë mënyre i dëmtuari është sjellë në lajthim me veprimet e të akuzuarit. Më pas, në kërkesë theksohet se mungojnë arsytet se në çfarë prova gjykata ka bazuar konkludimin e saj lidhur me fajësinë e të dënuarit.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ngase aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes i dënuari M.Sh. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.2 të KPK, sepse më datë 9.12.2012 në Mitrovicë me fshehjen e fakteve, me qëllim që vetit ose personit tjetër t'i sjell përfitim material, nga i dëmtuari B.B., mori parat si paradhënie për banesën 99 m² e cila ndodhet në katin e katërt të banesës në ndërtim e sipër e cila ndodhet në rrugën "11 M.." në M. Në emër të shitblerjes i dëmtuari ia kishte dhënë të dënuarit në tetor të vitit 2007 shumën e të hollave prej 15.300 €, kurse pas një muaj edhe 20.000 € me ç'rast i pandehuri i ka premtuar se banesën në fjalë do ta përfundoj, mirëpo të njëjtën në vitin 2012 ia shiti F.M., me të cilën ka lidhur kontratën mbi shitblerjen e të njëjtës banesë.

Në dispozitiv të aktgjykimit theksohet: "më datë 9.12.2012 në Mitrovicë me fshehjen e fakteve me qëllim që vetit ose personit tjetër t'i sjell përfitimi material nga

i dëmtuari B.B., mori paratë si paradhënie për banesën prej 99 m² në katin e katërt në rr. "11 M.." e cila ishte në ndërtim e sipër, kështu që i dëmtuari në tetor të vitit 2007 ia dha 15.300 € në prani të dëshmitarit V.H., duke lidhur para kontratë me Xh.H., kurse pas një muaji ia dha edhe 20.000 € në prani të V.H., i pandehuri i premtoi se banesën e cekur më lart do ta përfundojë, mirëpo i njëjti banesën e lartpërmendur në vitin 2012 ia shiti personit tjetër i quajtur F.M., me të cilin lidhi kontratë mbi shitblerjen për të njëjtën banesë".

Ky dispozitiv është i paqartë dhe në kundërshtim me shkresat e çështjes. Nga i njëjti nuk mund të kuptohet se cilat veprimet konkrete i ka ndërmarr i dënuari, të cilat do të konsideroheshin si mashtrim. Fillimisht duhet theksuar se nga dispozitivi rezulton se koha e kryerjes së veprës penale është 9.12.2012 ndërsa kontrata mbi shitblerjen e banesës është lidhur më datë 20.10.2007 në mes të M.Sh. si pronar i NPSH "V..." shitës dhe B.B., në cilësinë e blerësit. Më pas në dispozitiv qëndron konstatimi se "...i pandehuri i premtoj banesën e cekur më lartë se do ta përfundoj, mirëpo banesën e lartë përmendur në vitin 2012 ja shiti personit F.M. Ku konstatim është në kundërshtim me shkresat e çështjes sepse kjo kontratë është lidhur më 29.06.2009.

Paqartësia tjetër e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë konsiston në atë se nga i njëjti nuk mund të kuptohet se në çfarë mënyre i dënuari mashtrroi të dëmtuarin B.B., se cilat fakte ai ka fshehur me rastin e lidhjes së kontratës së parë për shitblerjen e banesës, kënd e mashtrroj, meqë banesa është shitur dy personave të ndryshëm, elementet këto qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

Në këtë dispozitiv nuk është përcaktuar dhe specifikuar mënyra e kryerjes së veprës penale edhe pse sipas dispozitës së nenit 335 të KPK, veprën penale të mashtrimit e kryen kush do që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryejë apo të mos kryejë një veprim në dëm të pasurisë së tij apo pasurisë së personit tjetër. Ndërsa elementi cilësues i veprës penale sipas paragrafit 2 siç kemi të bëjmë me rastin konkret, është nëse dobia pasurore e kundërligjshme ose shkaktimi i dëmit të ketë vlerën prej 10.000 € ose më shumë e që mungon ky fakt relevant në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Paqartësia tjetër e aktgjykimit të shkallës së parë qëndron në atë se në arsyetimin e aktgjykimit mungojnë arsye për faktet vendimtare. Kështu gjykata përveç përshkrimit narrativ të deponimeve të dëshmitarëve dhe listimit të provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, konstaton "...mbrojtja e të pandehurit ishte e paarsyeshme dhe jo bindëse për gjykatën por kishte për qëllim

ikje nga dënimi dhe përgjegjësia penale, pasi që edhe vet e pohon se banesën ia ka shitur të dëmtuarit e pastaj edhe personit tjetër e që për këtë janë përpiluar dy kontrata andaj gjykata mbrojtjen e tij nuk e aprovoi...” Pra, këtu mungon arsyetimi për dashjen si element subjektiv të kësaj veprë penale, po ashtu mungon analiza kritike e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht mungojnë arsye se në të cilat prova gjykata bazon konkludimin e saj, se në veprimet e të dënuarit përmbushen elementet e figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Pra, nuk janë dhënë arsye se në çfarë mënyre i dënuari e mashtroj , mbajti në lajthim dhe fshehë faktet ndaj të dëmtuarit B.B. Ky i dyti, fare nuk është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor edhe pse i njëjti ka iniciuar procedurën penale duke denoncuar të dënuarin në Polici. Me dëgjimin e tij, do të mund të vërtetoheshin faktet esenciale lidhur me ekzistimin e veprës, penale nga vërtetimi i të cilave varet edhe aplikimi i drejtë të ligjit penal.

Këto të meta, për të cilat me të drejtë pretendohet në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK.

Meqë gjykata e shkallës së dytë, nuk ka evituar shkeljet në fjalë për çfarë e obligon dispozita së nënti 394 të KPPK edhe ky aktgjykim është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për çfarë u deshtë që të dy aktgjykime të anulohen.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, duhet të administroj të gjitha provat e propozuara, por edhe prova tjera të cilat i konsideron të nevojshme për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike. Në veçanti, gjykata duhet të dëgjoj dëmtuarin B.B., si dhe dëshmitarin F.M., të cilët do të deklarohen lidhur me rrethanat e veprës penale në veçanti të sqarohen rrethana se si i dëmtuari është sjellë në lajthim, cilat fakte i ka fshehë i dënuari, për të mbajtur në lajthim të dënuarin B., me rastin e shitjes së banesës kontestuese dhe pas vlerësimit të provave në pajtim me nenin 361 par.2 të KPPK, të nxjerr një vendim të ligjshëm.

Nga arsyet e dhëna më sipër, e në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.353/2017, më 10 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta